5. Institucioni i licencuar shëndetësor i kontraktuar është i obliguar që pas përfundimit të kontrollit mjekësor t'i dërgojë kartelat mjekësore për secilin kandidat në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore për t'i dërguar në Drejtorinë e Personelit për procedurë të mëtutjeshme si në vazhdim: 5.1.Rezultatet mjekësore publikohen duke përcaktuar në mënyrë të qartë se kandidati ka kaluar apo ka dështuar në kontrollin mjekësor. 5.2.Pas publikimit të rezultateve kartela mjekësore vendoset në dosjen personale të kandidatëve. 5.3.Rekomandime profesionale mjekësore që parashihet në kartelë mjekësore, gjithmonë duhet të ceken problemet shëndetësore apo sëmundja që është pengesë për kandidatin që ta kryejë me sukses punën për të cilin ka konkurruar. 5.4.Pas përfundimit të testit psikologjik dhe mjekësor bëhet shpallja e rezultateve të kandidatëve.	5. Licencirana i ugovorena lekarska institucija dužna je da nakon okončanja lekarske kontrole da dostavi zdravstvene kartone, za svakog kandidata, u Direkciji zdravstvene službe da bi dostavila u Direkciji za osoblje za sledeći dalji postupak: 5.1. Lekarski rezultati objavljuju se, jasno utvrđujući da je kandidat “uspeo” ili “nije uspeo” na lekarskoj kontroli. 5.2. Nakon objavljivanja rezultata, zdravstveni karton postavi se u lični dosije kandidata. 5.3. Profesionalne lekarske preporuke koje se predviđaju na zdravstvenom kartonu, uvek treba da se navedu zdravstveni problemi ili bolesti koji je smetnja za kandidata da uspešno izvršava posao za koji je konkurisao. 5.4. Nakon završavanja psihološkog i lekarskog testiranja objavljuju se rezultati kandidata.	5. The licensed health institution contracted by Police after completing examinations is obliged to send medical cards to the Department of Human Resources for every candidate at the Directorate of Health Services in order to send them at the Directorate of Personnel for the further procedure as follows: 5.1. Medical examinations are published stating clearly that the candidate “has passed” or “has failed” in the medical examination. 5.2. After publication of results the medical card is placed in the personal candidate file. 5.3. Professional medical recommendations that are foreseen in the medical card, should always be stated the health problem or illness that is an obstacle for the candidate to perform successfully work for which has applied. 5.4. After the completion of the psychological and medical test, the results of the candidates are announced.
--	---	--

6. Departamenti për Burime njerëzore është përgjegjës për shpalljen e rezultateve meritore. 7. Të gjitha rezultatet dhe vlerësimet e testit mjekësor duhet të mbahen konfidenciale.	6. Uprava za Ljudske izvore je odgovorna za objavljivanje zaslužnih rezultata. 7. Svi rezultati i ocenjivanja lekarskog pregleda treba da su poverljivi.	6. The Department of Human Resources is responsible for announcing meritorious results. 7. All results and assessments of the medical tests should be kept confidential.
Neni 22 Verifikimi i të kaluarës 1. Pas publikimit të rezultatit meritore dhe rezultateve nga testi psikologjik dhe mjekësor, Sektori i Rekrutimit dhe Seleksionimit nëpërmjet Drejtorisë së Personelit, listën e kandidatëve të suksesshëm për kadet policor ia dërgon Drejtorisë për Hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës. 2. Pas përfundimit të verifikimit mbi të kaluarën, Drejtoria për Hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës aplikacionet me rezultatin e verifikimeve të kryera për secilin kandidat me rekomandim ia kthen Sektorit të Rekrutimit dhe Seleksionimit, e cila pastaj këto rezultate i vendos në bazën e të dhënave të Sektorit të Rekrutimit dhe Seleksionimit. 3. Nëse kandidati gjatë verifikimit mbi të kaluarën dështon, nuk do të ketë mundësi të punësohet në Polici.	Član 22 Provera prošlosti 1. Nakon objavljivanja zaslužnog rezultata i rezultata psihološkog i lekarskog testiranja, Sektoru za Rekrutovanja i Selekcije preko Direkcije Osoblja, listu uspešnih kandidata za policijske kadete šalje Direkciji za unutrašnje istrage i proveru prošlosti. 2. Nakon završetka provere prošlosti, Direkcija za unutrašnje istrage i proveru prošlosti, aplikacije sa rezultatom obavljenih provera za svakog kandidata, sa preporukom vraća Sektoru za Rekrutovanje i Selekciju, koja zatim ove rezultate ubacuje u bazi podataka Sektora Rekrutovanja i Selekcije. 3. Ukoliko kandidat tokom provere prošlosti podbaci, neće imati mogućnost zaposlenja u Policiji.	Article 22 Background check 1. After publishing final meritorious result and results from the psychological and medical tests, the Sector of Recruitment and Selection, through the Directorate of Personnel sends the list of successful candidates for police cadets to the Directorate of internal investigations and background check. 2. After completing background check, the Directorate of internal investigations and background checks sends the applications of completed verifications for each candidate by recommendation back to the Sector of Recruitment and Selection, which uploads these results in the data base of the Sector of Recruitment and Selection. 3. If the candidate fails during background verification, he/she will not be able to be employed in Police.

4. Lista e kandidatëve të suksesshëm të cilët ftohen për nënshkrimin e kontratës për punësim duhet të dërgohet brenda pesë (5) ditë para fillimit të trajnimit në Divizionin e Trajnimeve i cili është përgjegjës për organizimin, mbajtjen dhe zhvillimin e trajnimit.

Neni 23
Kontrata për punësim për kadet policor

1. Kadeti policor lidh kontratë të punës para se të filloj vijimin e trajnimit themelor. Sipas Aneksit 1 dhe Kontratën për kadet policor.

2. Pas nënshkrimit të kontratës për punësim, kandidatit i dorëzohet ftesa nga Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim për vijimin e trajnimit themelor për policinë e përgjithshme. Ky trajnim zhvillohet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa trajnimi realizohet nga personeli policor i Divizionit të Trajnimeve.

3. Nëse kandidati nuk e fillon trajnimin themelor brenda tri (3) ditëve pa arsye, konsiderohet se kandidati është tërhequr.

4. Nëse kadeti policor gjatë vijimit të trajnimit themelor sëmurët dhe merr pushim mjekësor, atij do t'i jepet

4. Lista uspešnih kanidata koji dobijaju poziv za potpisivanje ugovora za zapošljavanje, treba se postati u roku od pet (5) dana pre početka obuke u Diviziji Obuka koja je odgovorna za organizovanje, održavanje i odvijanje obuke.

Član 23
Ugovor o zapošljavanju za policijske kadete

1. Policijski kadet sklapa radni ugovor pre nego što počne sa osnovnom obukom. Vidi Aneks 1 i Ugovor za policijske kadete.

2. Nakon potpisivanja ugovora o zapošljavanju, kandidatu se daje pozivnica od Sektora za Rekrutovanje i Selekciju za pohađanje osnovne obuke za opštu policiju. Ova se obuka odvija u Kosovskoj Akademiji za Javnu Bezbednost, dok se obuka realizuje od policijskog osoblja Divize Obuka.

3. Ukoliko kandidat ne započne osnovnu obuku u roku od tri (3) a da nema opravdanje za to, smatra se da je odustao.

4. Ukoliko sepolicijski kadet tokom pohađanja osnovne obuke razboli i ide na bolovanje, njemu se pruža mogućnost da se

4. The list of successful candidates invited to sign in the contract of employment should be sent within (5) days before the training begins in the Training Division which is responsible for organizing, maintaining and developing the training.

Article 23
Employment Contract for police cadets

1. The police cadet enters into an employment contract before starting the basic training. In accordance with the Annex 1 and the Contract for Police Cadets.

2. After signing the employment contract, invitation will be sent to the candidate from the Selection and Recruitment Section for attending the basic training for general Police. This training is held at the Kosovo Academy for Public Safety, while the training will be conducted by the police personnel from the Training Division.

3. If the candidate does not start the basic training within three (3) days without any reason, it is considered that the candidate withdrew.

4. If the police cadet gets sick and uses a medical leave during the course of basic training, he/she will be given the

mundësia që në afatin prej tri (3) javësh të rikuperohet. Nëse edhe pas tri (3) javësh të pushimit mjekësor nuk ëshët rikuperuar dhe nuk ka mundësi të merr pjesë në trajnim, kadetit policor i ndërpritet trajnimi.

5. Kandidati i cili nuk i kryen të gjitha fazat e trajnimit me sukses (edhe pas dhënies se një mundësie të ritestimit) të njëjtit i i shkëputet kontrata e punës.

6. Kadetit policor mund t'i shkëputet kontrata në çdo kohë nëse nuk i përmbahet rregullave dhe procedurave të Policisë.

7. Kandidati i cili e kryen me sukses trajnimin themelor certifikohet si zyrtar policor dhe gjatë ceremonisë së diplomimit duhet ta japë betimin konform dispozitave të parapara me Rregullore për personel dhe administratë në Polici.

Neni 24 **Kontrata për punësim për** **zyrtar policor**

1. Pas certifikimit, kadeti policor lidh kontratë të re me të cilin e vazhdon marrëdhënien e punës me kohë të pacaktuar si zyrtar policor para se të filloj vijimin e trajnimit fushor. Sipas Aneksit 2 dhe Kontratën për zyrtar policor.

u roku od tri (3) nedelje bolovanja izleči. Ako se nakon tri (3) nedelje bolovanja ne izleči i nije u mogućnosti da učestvuje u obuci, policijskom kadetu se prekida obuka.

5. Kandidat koji ne završi uspešno sve faze obuke (i nakon davanja mogućnosti za ponovno testiranje), istom se raskida radni ugovor.

6. Policijskom kadetu se može raskinuti ugovor u svako doba ako se ne pridržava pravilima i procedurama policije.

7. Kandidat koji uspešno završi osnovnu obuku, sertifikuje se kao policijski službenik i tokom ceremonije diplomiranja treba da da zakletvu shodno odredbama predviđenim Pravilnikom za osoblje i administraciju u Policiji.

Član 24 **Ugovor o zapošljavanju za policijske** **službenike**

1. Nakon sertifikovanja, policijski kadet sklapa novi ugovor kojim nastavlja radni odnos na neodređeno vreme kao policijski službenik, pre nego što počne sa poljskom obukom. Prema Aneksu 2 i Ugovor za policijske službenike.

opportunity to recover within three (3) weeks. If after three (3) weeks of medical leave police cadet is not recovered and is unable to attend the training, the training for the police cadet is terminated.

5. The candidate who does not complete successfully all stages of the training (even after the re-testing chance has been given) the work contract is terminated.

6. The police cadet contract can be terminated any time if they do not obey to the Police rules and procedures.

7. The candidate who successfully completes the basic training is certified as police officer and during the graduation ceremony should give oath in accordance with the provisions provided by the Regulation of personnel and administration in Police.

Article 24 **Employment Contract for** **police officers**

1. After certification, the police cadet enters into a new contract with which he/she continues his/her employment for an undetermined period of time as a police officer before starting to attend the field training. See Annex 2 and the Contract for Police Officer.

2. Pas caktimit të vendit të punës, polici i ri është i obliguar ta ndjekë trajnimin fushor, në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh. 3. Polici i ri gjatë trajnimit fushor duhet të tregoj performancë të kënaqshme, me qëllim të përfundimit të trajnimit me sukses. Procedurat gjatë trajnimit fushor dhe vlerësimi i performances për policin e ri janë të parapara në Programin e trajnimit fushor për polic të ri. 4. Polici i ri gjatë trajnimit fushor, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikur të punësuarit e tjerë në Polici”. Neni 25 Marrëdhënia e punës për zyrtarët publik Marrëdhënia e punës për zyrtarët publikë në Policinë e Kosovës rregullohet sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe rregulloreve të Qeverisë që burojnë nga ky ligj.	2.Nakon odredjivanja radnog mesta, mlađi policajac je dužan da pohađa poljsku obuku u trajanju od 12 (dvanaest) meseci 3.Mlađi policajac tokom poljske obuke treba da pokaže zadovoljavajuću performansu sa ciljem uspešnog završavanja obuke. Procedure tokom poljske obuke i ocenjivanja performance za mlađjeg policajca su predviđjene programom poljske obuke za mlađe policajce. 4. Mlađi policajac tokom poljske obuke, realizuje sva prava i obaveze iz radnog odnosa kao ostali zaposleni u Policiji. Član 25 Radni odnos za javne službenike Radni odnos za javne službenike u Policiji Kosova se reguliše prema odredbama Zakona o Javnim Službenicima i pravilnicima Vlade koji proizilaze iz ovog zakona	2.After the new police officer is assigned to the workplace, he/she is obliged to attend the field training in duration of twelve (12) months 3.The new police officer during the field training must display satisfactory performance, in order to complete the training successfully. Procedures during field training and performance evaluation for new police officers are provided in the new police officers field training Program. 4. The new police officer during the field training, has all the rights and obligations from the work relation as other police employees. Article 25 Work relation for public officials The work relationship for public officials in the Kosovo Police is regulated according to the provisions of the Law on Public Officials and the Government's regulations stemming from this law.
---	--	---

Neni 26 Kartela identifikuese	Član 26 Identifikaciona kartica	Article 26 Identification Card
1. I gjithë personeli policor duhet të pajiset me kartelë identifikuese, në të cilën duhet të jetë fotografia, të dhënat personale të punonjësit, si dhe të dhëna tjera. Punonjësit janë të obliguar që gjatë orarit të punës, respektivisht gjatë qëndrimit në objektet e Policisë të bartin kartelën identifikuese. 2. Departamenti i Burimeve Njerëzore është i obliguar që një kopje të KI-së, kontratën e punës dhe numrin e llogarisë bankare të punonjësit ta dërgojë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. 3. Kartela identifikuese përmban të gjitha elementet e sigurisë. 4. Dizajni dhe të gjitha elementet e sigurisë së kartelës identifikuese aprovohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.	1. Celo policijsko osoblje treba da se snabdeva sa identifikacionom karticom, na kojoj treba da bude slika, lični podaci radnika kao i drugi podaci. Radnici su dužni da tokom radnog vremena, odnosno tokom boravka u objektima policije, nose identifikacionu karticu. 2. Uprava Ljudskih Izvora je dužna da jedan primerak IK, radni ugovor i broj žiroračuna u banci radnika šalje u Direkciju za Budžet i Finansije. 3. Identifikaciona kartica sadrži sve elemente bezbednosti. 4. Dizajn i svi elementi bezbednosti identifikacione kartice se odobravaju od Generalnog Direktora Policije.	1. The entire police personnel should be equipped with identification card, in which should be picture, personal data of employee, and other data. Employees are obliged that during working hours, respectively during presence at the Police facilities, wear identification card. 2. Department of human Resources is obliged that a copy of ID, work contract and bank account number of the employee send at the Directorate of Budget and Finances. 3. Identification card contains all safety elements. 4. Design and safety elements of identification card are approved by the general director of Police.

KAPITULLI V PAGA DHE SISTEMIMI I PERSONELIT TË POLICISË Neni 27 E drejta në pagë dhe e shpërblimit 1. Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë dhe në Ligjin e Pagave për zyrtarët publik. 2. Personeli i Policisë përfiton shtesë vjetore për performancë bazuar në rezultatet vjetore të vlerësimit të punës, ashtu siç e parasheh Rregullorja(QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të punësuarit në sektorin publik. Neni 28 Sistemimi i personelit 1. Sistemimi dhe transferi i personelit policor bëhet për vendet dhe detyrat e punës bazuar në Strukturën Organizative të Policisë dhe listën e personelit të autorizuar	V POGLAVLJE LIČNI DOHODAK I RASPOREDJIVANJE POLICIJSKOG OSOBLJA Član 27 Pravo na platu i na nagradu 1. Osnovna plata, dodaci za opasnost na posao, prekovremeni rad, rad u toku praznika, dnevni obrok, odeća i obuća (za policijske službenike) i zdravstveno osiguranje za osoblje Policije treba da je u skladu sa radnim mestom, činom, kvalifikacijom i radnim iskustvom na osnovu Zakona o Policij i Zakona o Platama za javne službenike. 2. Osoblje policije dobija godišnji dodatak za performansu na osnovu godišnjih rezultata ocenjivanja rada, onako kako predvidja Pravilnik (QRK) Br.08/2023 o Dodacima za zaposlene u javnom sektoru. Član 28 Rasporedjivanje osoblja 1. Rasporedjivanje i premeštaj policijskog osoblja, vrši se za položaje i dužnosti rada, na osnovu Organizacione Strukture Policije i liste ovlašćenog osoblja.	CHAPTER V SALARY AND DEPLOYMENT OF THE POLICE PERSONNEL Article 27 The right on salary and awards 1. The basic salary, allowances of risk at work, overtime work, holidays, daily meal, clothing (for police officers) and health insurance for the Police personnel must be in accordance to the position, rank, qualification and experience, according to the Law on Police and Law on Salaries of Public Officials. 2. Police personnel benefits from an annual performance allowance based on the annual results of the work evaluation, as provided for in Regulation (QRK) No. 08/2023 on Allowances for employees in the public sector. Article 28 Personnel deployment 1. The deployment and transfer of the police personnel is done for the positions and duties of work based on the Organizational Structure of Police and on the list of authorized personnel.
---	--	---

2. Pas certifikimit, polici i ri lidh kontratë të re të punës dhe sistemohet në vendin e punës me vendim të Drejtorit të Personelit. 3. Vendet e lira të punës duhet të plotësohen duke iu përmbajtur procedurave të rregullta të konkurrimit. Përgjegjësit e njësive të Policisë, të nivelit lokal apo qendror, të cilët nuk kanë staf të mjaftueshëm brenda njësisë të cilën e menaxhojnë, kërkesat e tyre për plotësimin e vendeve të lira të punës duhet t'ia adresojnë, përmes zinxhirit komandues, Departamentit të Burimeve Njerëzore, i cili është përgjegjës për menaxhimin e personelit. 4. Me rastin e caktimit apo sistemimit të punonjësve në vendet e lira të punës duhet të përfillen kushtet-kriteret të cilat parashihen për atë vend të punës. Punonjësi duhet të sistemohet në vendin e punës i cili i përgjigjet përgatitjes arsimore-kualifikimit, gradës, aftësive, shkathtësive profesionale të zyrtarit dhe përvojës së tij në punë. 5. Personelit të Policisë i garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi apo transferimi nga vendi i tyre i punës, pa analizë dhe vlerësim të performancës.	2. Nakon svakog sertifikovanja, mlađji policajac sklapa novi ugovor rada i raspoređuje se na radnom mestu sa rešenjem Direktora Osoblja. 3. Slobodna radna mesta treba da se popunjavaju pridržavajući se redovnim postupcima konkurisanja. Odgovorni policijskih jedinica, lokalnog ili centralnog nivoa, koji nemaju dovoljnog odobla u okviru jedinice koju menadžiraju, njihove zahteve za popunjavanje slobodnih radnih mesta treba da adresiraju preko komandnog lanca Upravi za ljudske izvore koja je nadležna za menadžiranje osoblja. 4. Prilikom odredjivanja ili sistematizacije radnika na slobodna radna mesta treba da se poštuju uslovi-kriterijumi koji se predviđaju za to radno mesto. Radnik treba da se sistematizuje na radno mesto koje odgovara stručnoj spremi-kvalifikaciji, činu, sposobnosti, profesionalnoj veštini službenika i njegovog radnog iskustva. 5. Osoblju policije se garantuje zaštita protiv bilo kojeg neopravdanog ili nepotrebnog udaljavanja ili premeštaja od njihovog radnog mesta, bez analize i ocene performanse.	2. After certification, the junior police officer enters into a new employment contract and is deployed in the workplace by decision of the Director of Personnel. 3. Vacancies must be fulfilled based on regular competing procedures. Responsible persons of Police units, of the local and central level who have not sufficient staff within the unit which they manage, must address their request for fulfilling work positions through the commanding chain to the Department of Human Resources, that is responsible for personnel management. 4. In case of assigning or deploying employees in vacant positions the criteria-conditions which are determined for that position must be respected. The employee must be deployed in the position that responds to his education-qualification, rank, abilities, and professional skills of the officer as well as his work experience. 5. Police personnel are guaranteed protection against any unreasonable or unnecessary dismissal or transfer from their position without any prior analysis of performance evaluation.
--	---	--

Neni 29 Sistemimi me pëlqimin e zyrtarit dhe punëdhënësit	Član 29 Sistematizacija uz saglasnost službenika i poslodavca	Article 29 Deployment with the consent of the officer and the employer
1. Me pëlqimin e zyrtarit dhe punëdhënësit, zyrtari mund të sistemohet prej një vendi në vendin tjetër të punës në bazë të: 1.1.përzgjedhjes së kandidatit sipas procedurës së brendshme të konkurrimit për pozitë të lirë në Polici dhe 1.2.sipas kërkesës personale të zyrtarit pas miratimit të kërkesës nga Njësia e cila e liron dhe Njësia e cila e pranon zyrtarin. 2. Autoritet vendimmarrës për transfer me kërkesë të policëve dhe rreshterëve në nivel lokal të organizimit janë Drejtorët Rajonal. Pas pëlqimit të drejtorëve rajonal, vendimin për transfere të tilla e lëshon Drejtoria e Personelit konform Strukturës Organizative dhe Listës së autorizuar të personelit të Policisë 3. Autoritet vendimmarrës për transfer me kërkesë të policëve dhe rreshterëve prej një Drejtorie/Njësi organizative në një Drejtori/ Njësi tjetër në nivel lokal apo qendrorë janë eprorët më të lartë, Drejtori i Divizionit, Drejtori i Departmentit ose	1. Uz saglasnost službenika i poslodavca, službenik se može sistematizovati iz jednog na drugo radno mesto na osnovu sledećih: 1.1.izbora kandidata prema unutrašnjoj proceduri konkurisanja za slobodan položaj u Policiji, i 1.2.na lični zahtev službenika posle odobrenja zahteva od Jedinice koja ga oslobađa i Jedinica koja prima službenika. 2. Organ odlučivanja za transfer sa zahtevom policajaca i vodnika na lokalnom nivou organizovanja su Regionalni Direktori. Posle odobrenja regionalnih direktora, rešenje o takvim transferima izdaje Direkcija za Osoblje shodno Organizacionoj Strukturi i Ovlašćene Liste Osoblja Policije. 3. Organ odlučivanja za transfer sa zahtevom policajaca i vodnika iz jedne Dierkcije/Organizacije jedinice u drugu Direkciju/Jedinicu na lokalnom ili centralnom nivou su najviše starešine, Direktor Divizije, Direktor Uprave ili	1. With the consent of the officer and the employer, the officer may be deployed from a position into another position based on: 1.1. the selection of the candidate according to the internal competing procedure for the vacancy in Police and; 1.2. Deployment based on the personal request of the officer, approval of the request by the Unit releasing and the unit receiving the officer. 2.The decision-making authority for the transfer at the request of police officer and sergeants at the local level of the organization is the Regional Directors. After the consent from the regional directors, the decision on such transfers is issued by the Directorate of Personnel in accordance with the Organizational Structure and the Authorized List of Police Personnel 3. The decision-making authority for the transfer at the request of police officer and sergeants from one Directorate /Organizational Unit to another Directorate/ Unit at the local or central

Zëvendës drejtori i Përgjithshëm ku është Njësia organizative. Pas pëlqimit të eprorëve të lartë, vendimin për transfere të tilla e lëshon Drejtoria e Personelit konform Strukturës Organizative dhe Listës së autorizuar të personelit të Policisë	Zamenik Generalnog Direktora gde je Organizaciona Jedinica. Nakon odobrenja viših starešina, rešenje o takvim transferima izdaje Direkcija Osoblja shodno Organizacione Strukture i ovlašćene liste osoblja policije.	level are the highest superiors, the Director of the Division, the Director of the Department or the Deputy General Director where the organizational Unit is located. After the consent of the superiors, the decision on such transfers is issued by the Directorate of Personnel in accordance with the Organizational Structure and the authorized List of Police Personnel.
4. Autoritet vendimmarrës për transfer me kërkesë të togerëve është Drejtori i Departementit përkatës.	4. Organ odlučivanja za transfer sa zahtevom poručnika je Direktor relevantne Uprave.	4. The decision-making authority for transfer at the request of lieutenants is the Director of the relevant Department.
5. Autoritet vendimmarrës për transfer me kërkesë të zyrtarëve nga Kapiten e më lart është Drejtori i Përgjithshëm.	5. Organ odlučivanja za transfer sa zahtevom službenika od Kapetana pa navise je Generalni Direktor.	5. The decision-making authority for transfer at the request of officials from Captain and above is the General Director.
6. Punonjësi i policisë, i cili konkurron në ndonjë njësi të ndjeshme (specializuar) brenda strukturës organizative të Policisë së Kosovës, dhe i cili me sukses i kryen të gjitha testimet dhe intervistat e parapara sipas konkursit, para përzgjedhjes dhe fillimit të punës në atë njësi, me kërkesën e përgjegjësit të njësive, ndaj tij duhet të bëhet verifikimi i së kaluarës.	6. Policijski radnik, koji konkuriše u neku osetljivu (specijalizovanu) jedinicu u okviru organizativne structure Policije Kosova, i koji uspešno vrši sva testiranja i intervjue predviđene konkursom, pre izbora i početka rada u toj jedinici, na zahtevu odgovornog jedinice, prema njemu se vrši i provera prošlosti.	6. Police employee, who applies in any sensitive unit (specialized) within the organizational structure of Kosovo Police, and who successfully completes all foreseen testes and interviews according to the competition, prior of selection and starting work in that position, by the request of the supervisor of unit, against him shall be conducted the background verification.
7. Punonjësi i Policisë i cili ka kryer trajnime të specializuara me investim të Policisë, ai është i obliguar të qëndroj në njësinë përkatëse për të cilën ka kryer specializim jo më pak se pesë (5) vite. Nëqoftëse punonjësi jep dorëheqje prej policisë pa kaluar pesë (5) vite, është i	7. Radnik policije koji je završio specijalizovane obuke investicijom policije, dužan je da ostane u relevantnoj jedinici za koju je završio specijalizacije, ne manje od pet (5) godina. Ukoliko radnik daje ostavku iz policije a da nisu prošle pet godine, on je dužan da proporcionalno	7. The Police employee who has completed specialized training with the investment of the Police is obliged to stay in the relevant unit for which he has completed specialization no less than five (5) years. If the employee resigns from the police

obliguar që të bëjë kompensimin proporcional për investimin e tij gjatë kryerjes së trajnimit dhe në përputhje me kontratën e nënshkruar me Divizionin e trajnimeve.	nadoknadi njegovu investiciju tokom završavanja obuke i u skladu sa potpisanim ugovorom sa Divizijom obuka.	before five (5) years, he is obliged to make proportional compensation for the investment during the training and in accordance with the contract signed with the Training Division.
8. Personeli policor i cili punon dhe ata që konkurrojnë në njësi në të cilat kanë qasje në informacione të klasifikuara, mbështetur në Ligjin për Klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë, domosdo duhet t'iu nënshtrohen verifikimit të sigurisë, siç përcakton Ligji dhe aktet tjera nënligjore mbi procedurat e verifikimit të sigurisë.	8. Policijsko osoblje koji rade i oni koji konkurišu u jedinici u kojima imaju pristup poverljivim informacijama, na osnovu Zakona o Klasifikaciji Informacije i proveru prošlosti, neophodno je da se podvrgnu proveru prošlosti, kako određuje zakon i ostali podzakonski akti o procedurama provere bezbednosti.	8. Police personnel who works and the ones who apply in that unit that have access in classified information, according to the Law on Classification of Information and Verification of Security, necessarily should be subjected Verification of Security, according to the Law and other sublegal acts on the Procedures of Verification of Security.
Neni 30 Sistemimi për kohë të caktuar apo për kohë të pacaktuar pa pëlqimin të punonjësit	Član 30 Sistemiranje na određeno ili neodređeno vreme bez saglasnosti radnika	Article 30 Deployment without the consent of the employee for the determined or undetermined period of time
Sistemimi pa pëlqim të punonjësit	Sistemiranje bez saglasnosti radnika	
1. Personeli policor për shkak të nevojave operationale të shërbimit, pa pëlqimin e tij/saj, mund të sistemohet për kohë të caktuar-prej një vendi në një vend tjetër të punës. 2. Në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, punonjësi pa pëlqimin e tij mund të sistemohet për kohë të caktuar në vendin e punës me pozitë më të ulët se	1. Policijsko osoblje, zbog operacionalih potreba službe, bez njegove/njene saglasnosti može, da se sistemira na određeno vreme sa jednog na drugo radno mesto. 2. U slučajevima vanrednog stanja, radnik bez njegove saglasnosti može da se sistemira na određeno vreme na radno mesto sa nižim položajem od onog kojeg je	1. Police personnel, as a result of operational needs of the service, without their consent, may be deployed for a determined time from a work position to another one. 2. In case of an extraordinary circumstances, the employee without his consent may be deployed for a determined period in a position in a lower rank than the previous position. The decision-

pozita të cilën e ka pasur. Autoriteti vendimmarrës është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. 3.. Përveç sistemimit/transferit nga paragrafët paraprak të këtij neni, për shkak të nevojave operacionale të shërbimit, në nivelin lokal të organizimit të policisë Drejtorët e Drejtorive Rajonale janë kompetent për transferin e policëve dhe rreshterëve brenda drejtorisë së tyre përkatëse, ndërsa transferin e zyrtarit policor me gradën e togerit është në kompetencë të Drejtorit të Divizionit, Departamentit, Zëvendës Drejtorit si njësi organizative përkatëse në të cilin punon zyrtari policor. 4.Autoriteti vendimmarrës për sistemimin-e personelit të policisë me gradën-Kapiten, Major, Nënkolonel, Kolonel , Drejtor Departamenti dhe pozitat drejtuese është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ndërsa Drejtoria e Personelit lëshon vendim. 5. Dispozitat e paragrafit 1, 2, 3, 4 të këtij neni nuk vlejné për komandantët e stacioneve dhe nënstacioneve policore në territoret ku komuniteti serb është komuniteti ma i madh etnik, të cilët emërohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, konform dispozitave të nenit 42 të Ligjit për Policinë e Kosovës.	imao. Organ odlučivanja je Generalni Direktor Policije. 3. Osim sistemirnaja/premeštaja iz prethodnih stvova ovog člana, zbog operacionalnih potreba službe, na lokalnom nivou organizovanja policije Direktori Regionalnih Direkcija su nadležni za premeštaj policajaca i vodnika u okviru odgovarajuće direkcije , dok premeštaj policijskog službenika sa činom poručnika je u nadležnosti Direktora Divizije, Uprave, Zamenika Direktora kao relevantna organizaciona jedinica u kojoj radi policijski službenik. 4. Organ odlučivanja za sistemiranje osoblja policije sa činom Kapeta, Majora, Potpukovnika, Pukovnika,Direktora Uprave je Generalni Direktor, dok Direkcija Osoblja izdaje rešenje. 5.Odredbe stava 1, 2, 3, 4 ovog člana ne vrede za komandire policijskih stanica i podstanica u sredinama gde je srpska zajednica većinska etnička zajednica, koji se imenjuju direktno od Ministarstva Unutrašnjih Poslova, shodno odredbama člana 42 Zakona o Policiji Kosova.	making authority is the General Director of Police. 3. Except deployment/transfer from the previous paragraphs of this article, as a result of the operational needs of the service, at the local level of the police organization the Directors of the Regional Directorates are competent for transferring police officers and sergeants within their directorates, while the transfer of the police officer holding the rank of lieutenant is under the competency of the Director of the Division, Department, deputy Director as a respective organizational unit where the officer works. 4. The decision-making authority for the deployment of police personnel with the ranks of Captain, Major, Lieutenant Colonel, Colonel, Department Director and management positions is the General Director of Police, while the Personnel Directorate issues a decision. 5.The provisions of the paragraph 1, 2, 3, 4 of this article are not applicable for police station and substation commanders in the territories where the serbian community is the largest ethnic community, who are appointed by the Ministry of Internal Affairs, pursuant to the provisions of the article 42 of the Law on Kosovo Police.
---	---	---

6. Sistemimi i personelit policor do të rregullohet më në detaje me PSO nga Drejtoria e Personelit.	6. Sistematizacija policijskog osoblja detalnije će se uređivati OSP-om od strane Direkcije za osoblje.	6. Deployment of the police personnel will be regulated in details by SOP from Directorate of Personnel.
7. Afati i kohëzgjatjes së sistemimit për kohë të caktuar është më së shumti gjashtë (6) muaj brenda një viti. Në rast vazhdimi me aprovim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.	7. Rok vremenskog trajanja sistemiranja na odredneo vreme je najviše šest 6 meseci unutar jedne godine u slučaju produžavanja sa odobnjem Generalnog Direktora.	7. The period of deployment for determined period is not more than six(6) months within a year. in case of extension with the approval of the General Director of Police.
8. Personeli i sistemuar për kohë të caktuar sipas paragrafit 2 deri 4 të këtij neni i gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficinet nga pozita e mëparshme.	8. Privremeno sistemirano osoblje na određeno vreme prema članu 2 do 4 ovog člana ima sva prava i koristi beneficije od prethodnog položaja.	8. The personnel deployed for a determined period according to the paragraph 2 and 4 of this article enjoys all the rights and benefits from the previous position.
9. Sistemimi i personelit policor sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni mund të bëhet më së shumti një gradë/pozitë më të ultë.	9. Sistematizacija policijskog osoblja prema tačke 1 i 2 ovog člana može se vršiti najviše za jedan čin/položaj niži.	9. Deployment of the police personnel according to the point 1 and 2 of this Article may be done up to one lower rank/position.
10. Zyrtari policor mund të sistemohet konform këtij udhëzimi administrativ në ndonjë pozitë tjetër të përshtatshme për shkaqe shëndetësore të sëmundjes së rëndë, shkaqe të sigurisë së vetë punonjësit ose në situatat kur i merret arma zyrtare në mënyrë të ligjshme.	10. Policijski službenik može da raspoređuje ovim administrativnim upustvom u drugi pogodni položaj zbog zdravstvenih razloga radi teških bolesti, iz razloga bezbednosti samih radnika ili u situacijama u kojima službeno oružje mu se oduzima na legalan način.	10. A police officer can be deployed conform this administrative instruction in any other suitable position because of health reasons of serious disease, security reasons of the workers themselves in situations where an official weapon is legally taken.
11. Nëse për shkaqe shëndetsore zyrtari policor sistemohet në ndonjë pozitë/detyrë më të lehtë që i përshtatet gjendjes së tij/saj shëndetësore, atëherë të njëjtit i takon shtesa e rrezikshmëris ekuivalente me detyrën të cilën do ta ushtroj.	11. Zbog zdravstvenih razloga, policijski službenik se raspoređuje na neki lakši položaj/zadatak koji odgovara njegovom/njenom zdravstvenom stanju, onda njemu pripada dodatak za rizik ekvivalentna sa zadatkom koju obavlja.	11. If for the health reasons, the police officer is employed in an easier duty/position that suits his/her health condition, then he is entitled to the same hazard allowances equivalent with the position to be exercised.

12. E punësuar gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë, e punësuar me fëmijë deri në moshën tri (3) vjeç, prindi i vetëm me fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç, prindi i punësuar me fëmijë me aftësi të kufizuar, i punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç si dhe i punësuar me aftësi të kufizuara, nuk mund të sistemohen jashtë vendbanimit të tyre, pa pëlqimin e tyre.

13. Sistemimi për kohë të caktuar i zyrtarit policor sipas paragrafit paraprak të këtij neni për shkaqe të sëmundjes së rëndë, bazuar në konstatimin e komisionit mjekësor dhe rekomandimit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore mund të lirohet nga mbajtja e uniformës dhe pajisjeve policore.

Neni 31 Sistemimi në pozitë më të ultë

1. Sistemimi i punonjësit në pozitë apo kategori më të ulët funksionale, pa pëlqimin paraprak të tij, mund të bëhet në kushtet dhe rrethanat të cilat nuk kufizohen vetëm në:

1.1. kalimin e mandatit, ku zyrtari policor i nivelit të lartë ekzekutiv kthehet në pozitën apo gradën e mëparshme të cilën e ka pasur;

12. Zaposlena tokom trudnoće, prodirskog odsustva, zaposlena sa decom do tri (3) godina starosti, samohrani roditelj sa decom ispod pet (5) godina starosti, zaposleni roditelj sa detetom ograničene sposobnosti, zaposleni ispod osamnaest (18) godina kao i zaposleni sa ograničenim sposobnostima, ne mogu se sistemirati van njihovog mesta staovanja bez njihove saglasnosti.

13. Sistemiranje na određeno vreme policijskog službenika prema prethodnom stavu ovog člana zbog teške bolesti, na osnovu utvrdjenja zdravstvene komisije i preporuke Direkcije za Zdravstvene službe može se osloboditi od nošenja uniforme i policijske opreme.

Član 31 Sistematizacija na niži položaj

1. Sistematizacija radnika na nižem funkcionalnom položaju ili kategoriji, bez njegove predhodne saglasnosti, može se uraditi pod uslovima i okolnostima koji se ne ograničavaju samo na:

1.1. isteklom mandatu, kada policijski službenik višeg izvršnog nivoa vrati se u predhodnom položaju ili činu koje je imao;

12. The employee during pregnancy, maternity leave, employee with children up to three (3) years of age, single parent with children under five (5) years of age, employed parent with disabled children, employee under the age of eighteen (18) as well as the employee with disabilities, cannot be deployed outside their location of residence, without their consent.

13. Deployment for a determined period of police officer according to the previous paragraph of this article because of serious disease, based on findings of medical committee and the recommendation of the Directorate of Health Services can be released from wearing the police uniform and equipment.

Article 31 Deployment in a lower/higher position

1. Deployment of the employee in a lower functional category or position, without his previous consent, may be done in conditions and circumstances which are not limited in:

1.1. The end of the mandate, where the police officer of the high executive level is returned in the previous position or rank;

1.2.vlerësimin e dobët të performancës në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të punës; 1.3.paaftësisë në punë, si rezultat i sëmundjes së gjatë ose paaftësisë fizike, bazuar në konstatimin e komisionit mjekësor dhe rekomandimit të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore. 1.4.zhvillimin e hetimeve penale dhe procedurës disiplinore dhe 1.5.shqiptimin e masës disiplinore. 2. Me rastin e sistemimit nga nënparagrafi 1.3. e paragrafit paraprak, punonjësi duhet të sistemohet në vendin e punës që u përgjigjet apo u përshtatet aftësive dhe ndryshimeve të tij shëndetësore. 3. Transferi nga nënparagrafi 1.4, e paragrafit 1, zgjat deri në përfundim të hetimeve disiplinore. 4. Ndërsa kur është në pyetje sistemimi si rezultat i shqiptimit të masës disiplinore, punonjësi përveç që mund të transferohet në pozitë më të ulët, atij mund t'i ulet edhe gradat.	1.2. slabo ocenjivanje performanse na ispunjavanju dužnosti i radnih obaveza. 1.3. radne nesposonosti, kao posledica duže bolesti ili fizičke nesposobnosti na osnovu ustanovljavanja lekarske komisije i preporuke Direkcije zdravstvenih službi. 1.4. odvijanjem krivične istrage i disciplinskog postupka; i 1.5. izricanjem disciplinske mere. 2. Prilikom sistematizacije iz pod stava 1.3 prethodnog stava, radnik treba da se sistematizira na radno mesto koje odgovara ili se prilagodi njegovoj sposobnosti ili njegovim zdravstvenim izmenama. 3. Sistematizacija iz pod stava 1.4 pr stava 1, traje do okončanja disciplinskih istraga. 4. Dok je u pitanju sistematizacija kao rezultat izricanja disciplinske mere, radnik, osim što se može premestiti na niži položaj njemu se može umanjiti i čin.	1.2.Unsatisfactory evaluation of the performance in performing duties and obligations; 1.3.Inability to work due to long disease or physical inability, based on findings of the medical committee and the recommendations of the Directorate of Health Service. 1.4.conduct of criminal and disciplinary investigations; and 1.5.Imposing the disciplinary measure. 2. In case of deployment from the sub-paragraph 1.3 of the previous paragraph, the employee must be deployed in the position that responds or suits to abilities and changes of his medical conditions. 3. The transfer from the sub-paragraph 1.4 and paragraph 1 lasts up to the end of the disciplinary investigations. 4. While, when it is about the deployment as a result of imposing the disciplinary measure, the employee besides the fact that he cannot be transferred in a lower position, he may be reduced in rank.
---	--	--

Neni 32 Sistemimi si rezultat i ristrukturimit apo riorganizimit	Član 32 Sistematizacija kao rezultat restrukturiranja ili reorganizovanja	Article 32 Deployment as a result of restructuring or reorganization
1. Personeli policor në rast të ristrukturimit, riorganizimit apo ndryshimit të strukturës organizative, mund të sistemohet në vend apo pozitë tjetër të nivelit dhe shkallës së njëjtë të punës (transferi paralel-horizontal), me kusht që vendi i ri i punës t'u përgjigjet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 28 (Sistemimi i personelit) të këtij udhëzimi administrativ. 2. Nëse për shkak të ristrukturimit apo riorganizimit të Policisë nuk ka vende-pozita të lira të nivelit të njëjtë që i përgjigjen përgatitjes dhe aftësive profesionale, atëherë personeli mund të transferohet në një pozitë më të ulët, e cila mund të mos i përgjigjet gradës dhe përgatitjes së tij profesionale. Ky transfer duhet të zgjasë vetëm derisa të krijohen vende të reja të punës që i përgjigjen përgatitjes profesionale të punonjësit të transferuar. 3. Sistemimi i personelit sipas paragrafit 2 të këtij neni i mban të gjitha të drejtat dhe beneficionet nga pozita e mëparshme.	1. Policijsko osoblje u slučaju restrukturiranja, reorganizovanja ili izmene organizativne strukture, može se sistematizovati na drugo radno mesto ili položaj istog nivoa i stepena (paralelan-horizontalan premeštaj), pod uslovom da novo radno mesto odgovara uslovima i kriterijumima predviđeni članom 28 (Sistematizacija osoblja) ovog Administrativnog uputstva. 2. Ukoliko zbog restrukturiranja ili reorganizovanja Policije nema slobodno mesto-položaj istog nivoa koje odgovara profesionalnoj spremi i sposobnostima, onda se osoblje može premestiti na niži položaj, koji može da ne odgovara njegovom činu i stručnoj spremi. Ovaj premeštaj treba da traje sve dok se stvara novo radno mesto koje odgovara stručnoj spremi premeštanog radnika. 3. Sistematizacija osoblja iz stava 2 ovog člana snosi sva prava i beneficije iz predhodnog položaja.	1. Police personnel in case of restructuring, reorganizing or change of the organizational structure may be deployed in another work place or position of the level of the same job (parallel-horizontal transfer), provided that the new vacancy is suitable to conditions and criteria determined by the Article 28 (Deployment of personnel) of this administrative instruction. 2. If due to the restructuring or reorganizing of Police there are no vacant-positions of the same level that respond to professional abilities and education, then personnel may be transferred to a lower position, which may not respond to the rank and his professional education. This transfer may last only until there are new vacancies that respond to professional education of the transferred employee. 3. Deployment of personnel according to the paragraph 2 of this Article holds all the rights and benefits from previous position.

4. Sistemimi i personelit policor sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni mund të bëhet më së shumti një gradë/pozitë më të ultë. Neni 33 Vënia në dispozicion e personelit 1. Personeli policor mund që për shkak të ristrukturimit apo riorganizimit të Policisë, sëmundjes së rëndë dhe hetimeve, të vihet në statusin në dispozicion. 2. Policia e Kosovës duhet të bëjë përpjekje që personelin policor ta sistemojë në përputhshmëri me gradën apo kualifikimin. 3. Gjatë kohës së qëndrimit në dispozicion, personeli policor angazhohet nga mbikëqyrësi për kryerjen e detyrave në pajtim me gradën dhe kualifikimin që ka.	4. Sistematizacija policijskog osoblja prema tačke 1 i 2 ovog člana može se vršiti najviše za jedan manji čin/položaj. Član 33 Stavljanje osoblja na raspolaganju 1. Policijsko osoblje može zbog restrukturiranja ili reorganizovanja Policije, bolesti i istrage da se postavi na statusu raspolaganja. 2. Policija Kosova treba da se zalaže da policijsko osoblje sistematizuje u skladu sa činom ili kvalifikacijom. 3. Za vreme ostajanja na raspolaganju, policijsko osoblje se angažuje od strane nadzornika za izvršenje zadataka u skladu sa činom ili kvalifikacijom koje ima.	4. Deployment of police personnel according to the point 1 and 2 of this Article may be done in at least one lower rank/position. Article 33 Putting the staff into available status 1. Police personnel due to restructuring or reorganizing of Police, due to disease or investigations may be given the available status. 4. Kosovo Police should make efforts to deploy the police personnel in accordance to his rank or qualification. 3. During the availability time, the police personnel are appointed by his superior to perform duties according to his rank or qualification.
Neni 34 Caktimi i ushtruesit të detyrës 1. Kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, atëherë me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, përkohësisht caktohet ushtruesi i detyrës.	Član 34 Odredjivanje vršioca dužnosti 1. Kada potrebe službe zahtevaju popunjavanje nekog slobodnog radnog mesta onda odlukom generalnog direktora Policije, privremeno se odredjuje vršioc dužnosti.	Article 34 Appointing in acting position 1. When the needs of service require filling a vacancy, then by a decision of the general director of Police, a person in acting position is appointed, 2. An officer acting in position is appointed for the period up to six (6) months, in case

2. Ushtruesi i detyrës caktohet për periudhën kohore në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj, ne rast vazhdimi me aprovim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.	2. Vršioc dužnosti određuje se za vremenski period u trajanju do šest (6) meseci u slučaju produžavanja sa odobrenjem Generalnog Direktora Policije.	of extension with the approval of the General Director of Police.
